



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Data: 28 Gusht 2023

Nr: 739

Ora: 12:00

V E N D I M

P Ë R

SHQYRTIMIN ADMINISTRATIV TË DENONCIMIT NR. 421 ID NGA QENDRA “QËNDRESA QYTETARE”, NDAJ ZJ. ANILA KALA, DREJTOR I SPITALIT RAJONAL, BERAT, PËR SHKELJE ADMINISTRATIVE, NË ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE TË DATËS 14 MAJ 2023

Sot më datë 28 Gusht 2023, unë Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve mora në shqyrtim çështjet administrative me:

KËRKUES: Qendra “Qëndresa Qytetare”

SUBJEKT: Zj. Anila Kala, Drejtor i Spitalit Rajonal, Berat

OBJEKT: Shqyrtimi administrativ ndaj personit përgjegjës për shkelje administrative, për postime në faqen e rrjetit social “Facebook”

BAZA LIGJORE: Në mbështetje të nenit 19, pika 1, shkronjat “dh”, “f” dhe “n”, pika 2, neneve 91, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, vendimit nr. 9, datë 9.3.2021 dhe vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator

Në përfundim të këtij shqyrtimi,

K O N S T A T O J :

Nga Qendra “Qëndresa Qytetare” është depozituar denoncimi për të cilën denoncuesi pretendon se institucione publike kanë publikuar postime apo kanë ripostuar publikime me përmbajtje elektorale në faqet zyrtare të tyre, të cilat përbëjnë përdorim të burimeve publike.

Data: 28 Gusht 2023

Nr: 739

Ora: 12:00



“Për shqyrtimin administrativ të denoncimeve nr. 421 ID për shkelje administrative”

Subjekti i denoncuar është Drejtori i Spitalit Rajonal, Berat.

Denoncimi është marrë nëpërmjet provave link dhe materialeve fotografike, të administruara nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve dhe depozituar nga Qendra “Qëndresa Qytetare”.

Denoncuesi ka paraqitur pretendimet si më poshtë vijon:

Denoncimi regjistruar me nr. 421 ID, ndaj Drejtorit të Spitalit Rajonal, Berat, me kërkues Qendra “Qëndresa Qytetare”, ku pretendohet si më poshtë vijon:

“Më datë 7 maj 2023, faqja zyrtare e Spitalit Rajonal të Beratit ka postuar në rrjetin social Facebook, një poster të fushatës së kandidatit dhe subjektit zgjedhor “Partia Socialiste e Shqipërisë”. Në poster vihen re elementet e përdorura nga ana e Partisë Socialiste përgjatë fushatës zgjedhore, si sllogani: “Vetëm përpara, kurrë më mbrapa” dhe deklarimi se “Berati mirëpret Edi Ramën”.

Neni 19, pika 1, shkronja “dh”, “f” dhe “n” e pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar përcakton kompetencat që ushtron Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve.

Mbështetur në përcaktimet e nenit 8, pika 3, të vendimit nr. 9, datë 9.3.2021, të Komisionit Rregullator, u shqyrtuan paraprakisht çështjet dhe u vlerësuan se informacioni apo të dhënat e treguara krijojnë një bazë të mjaftueshme për t’u nisur hetimi administrativ.

Referuar nenit 7, të ligjit nr. 10279, datë 20.05.2010, “Për kundravajtjet administrative”, kompetenca për konstatimin e kundërvajtjes, me përjashtim të rasteve kur ligji parashikon ndryshe, i takon organit administrativ, përgjegjës për zbatimin e ligjit të posaçëm, titullarit të organit administrativ, që merret me zbatimin e ligjit, në rastet kur ligji nuk shprehet për kompetencën për shqyrtimin e kundërvajtjes dhe nxjerrjen e vendimit përkatës.

Në vijim të procedurës administrative, filloi shqyrtimi administrativ, duke verifikuar provat si dhe duke kërkuar informacion në lidhje me publikimet e postuara me përmbajtje elektorale dhe slogane elektorale.

Nëpërmjet postës elektronike, më datë 16.5.2023, personit përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike në Spitalin Rajonal të Beratit, i është kërkuar informacion sqarues në lidhje me çështjen objekt shqyrtimi, dhe më datë 17.5.2023 nëpërmjet postës elektronike, është sqaruar nga personi përgjegjës se: *“Në lidhje me këtë rast sporadik ka ndodhur një lapsus, gabim njerëzor në shpërndarjen në faqen zyrtare të një materiali gabimisht. Sapo u evidentua që ky postim ishte bërë në faqen zyrtare të institucionit dhe jo në faqen personale*

u morën masa direkt për heqjen e këtij postimi pasi ne jemi një institucion i cili mbulon një shërbim të rëndësishë së veçantë dhe të ndjeshëm për komunitetin.”

Për shkak të kompleksitetit të çështjes, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, nëpërmjet vendimit nr. 691, datë 12.07.2023 “Për zgjatjen e afatit të denoncimeve regjistruar me nr. 417 ID, 421 ID, 429 ID dhe 431 ID, për shkelje administrative për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 Maj 2023”, ka vendosur zgjatjen e afatit të shqyrtimit administrativ të denoncimit regjistruar me nr. 421 ID.

Në përfundim të procedurës administrative, pas konsultimit me të gjitha provat dhe faktet, më datë 27 Korrik 2023 nëpërmjet postës elektronike, palëve në këtë proces i është kërkuar paraqitja e pretendimeve përfundimtare përpara se të vijohet me vendimmarrje. Personi përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike, në përgjigjë të kërkesës sonë për paraqitjen e pretendimeve përfundimtare ndër të tjera bën me dije se: *“Bazuar në e-mailin e datës 27.07.2023, protokolluar me tonën me nr. 3390 prot., datë 27.07.2023, ku kërkohen pretendimet përfundimtare mbi denoncimin me nr. 421 ID, ju bëjmë me dije se i’u qëndrojmë pretendimeve tona të mëparshme , si më poshtë vijon:*

Në lidhje me këtë rast sporadik ka ndodhur një lapsus, gabim njerëzor në shpërndarjen në faqen zyrtare të një materiali gabimisht.

Sapo u evidentua që ky postim ishte bërë në faqen zyrtare të institucionit dhe jo në faqen personale u morën masa direkt për heqjen e këtij postimi pasi ne jemi një institucion i cili mbulon një shërbim të rëndësishë së veçantë dhe të ndjeshëm për komunitetin”.

Në fazën e përfundimit të hetimit administrativ pas administrimit të përgjigjeve me lëndë “Kërkese për informacion” dhe pas verifikimit të faqes së rrjetit social “Facebook”, nën emrin Spitali Rajonal, Berat, u konstatua se postimet me përmbajtje elektorale, objekt shqyrtimi janë fshirë.

Për sa më sipër, të ndodhur në kushtet ku referuar provave dhe fakteve mbi denoncimin nuk gjendemi para shkeljes administrative të legjislacionit në fuqi, vlerësoj se duhet të pushohet shqyrtimi administrativ ndaj Drejtorit të Spitalit Rajonal, Berat.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 19, pika 1, shkronjat “dh”, “f” dhe “n”, pika 2, nenet 91, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, vendimit nr. 9, datë 9.3.2021 dhe vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator

V E N D O S:

1. Pushimin e shqyrtimit administrativ ndaj zj. Anila Kala, Drejtor i Spitalit Rajonal Berat.
2. Rezultatet e këtij vendimi i njoftohen palëve nëpërmjet postës elektronike.

Data: 28 Gusht 2023 Nr: 739
Ora: 12:00



“Për shqyrtimin administrativ të denoncimeve nr. 421 ID, për shkelje administrative”

3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga shpallja e tij.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI

